



Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Pogradec

VITI 2019

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në familje të ”Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA, UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Autoret

Ardiana Kasa - Tjetër Vizion

Esmeralda Hoxha, “Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	5
PËRSE MONITORIM I SKBGJ-SË NGA OSHC-TË?	6
METODOLOGJIA	6
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	8
GJETJET KRYESORE	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË POGRADEC	9
TË DHËNA STATISTIKORE NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT POGRADEC	10
TË DHËNA STATISTIKORE NGA DREJTORIA E POLICISË POGRADEC	10
TË DHËNAT STATISTIKORE NGA GJYKATA E RREHIT GJYQËSOR POGRADEC.....	11
TË DHËNA STATISTIKORE NGA PROKURORIA E RREHIT GJYQËSOR POGRADEC.....	11
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019	11
KONKLUZIONE	22
REKOMANDIME	23

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZHK "Sot për të Ardhmen"	Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve në lidhje me zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, nën Programin e Përbashkët të KB "Përfundimi i Dhunës ndaj Grave" të financuar nga Qeveria e Suedia po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare. Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, nga disa nga anëtarët e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhë, Kamëz, Fier, Sarandë dhe Pogradec.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 pr bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës nëntor 2019- Maj 2020. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga disa prej anëtareve të RrFGSh i dhe disa organizata të tjera, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin të Qëllimit strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Organizatat partnere në projekt të rrisin për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe punën e mekanizmave të referimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
2. Proçesi i monitorimit nga u përfundua me sukses brenda afateve të zbatimit të projektit pasi edhe pse nën ndikimin e krizës COVID-19, institucionet përgjegjëse dërguan në kohën e duhur informacionet e kërkuara zyrtarisht.
3. U realizua proçesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proçeseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC në nëntor 2019 Përvec manualit u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë proçesit të monitorimit.

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGJZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGJZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz QAGJZh bashkëpunoi me një pjesë të organizatave të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh, si dhe me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vizion, Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një

experte lokale u përzgjedh për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2019.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
 - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
 - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikën për

menaxhimin e rasteve të dhunës në familje ne nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkite ne nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën www.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Të dhëna të përgjithshme Bashkia Pogradec

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 61.530 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 90.976 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 548.77 km².

Bashkia Pogradecit përbëhet nga 8 njësi administrative dhe ka nën administrimin e saj një qytet dhe 72 fshatra. Nga pikëpamja administrative Bashkia e Pogradecit ka bashkuar në një të vetme të gjitha njësitë e Rrethit të Pogradecit, duke ruajtur të njëjtët kufinj territorialë që ka pasur rrethi. Kësaj ndarje të re territoriale i janë bashkuar edhe disa zona të thella malore.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019.

Gjetjet kryesore

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë bashkisë Pogradec gjatë vitit 2019 në mbledhjet e Grupit Teknik Ndërdisciplinar ka trajtuar në mënyrë të bashkërenduar 10 raste të viktimave të dhunës në familje.
- Për periudhën janar – dhjetor 2019 në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Pogradec janë regjistruar 58 kërkesë padi me objekt lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhërit të

Mbrojtjes. Në të njëjtën periudhë kohore pranë kësaj gjykate janë regjistruar 17 çështje penale me akuzën “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.²

- Pranë Policisë Vendore të bashkisë Pogradec gjatë vitit 2019 u evidentuan 81 raste të dhunës në familje me 83 persona të dëmtuar, 69 prej këtyre viktimave ishin gra dhe vajza.
- U evidentua numër i ulët i arrestimit të autorëve, dhunues në familje me vetëm 22 arrestime, 11 persona të ndaluar dhe 4 të shpallur në kërkim.
- Bashkia Pogradec gjatë vitit 2019 në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile që operojnë në territorin e saj ka organizuar 13 aktivitete me komunitetin për ndërgjegjësimin për të mos pranuar dhunën me bazë gjinore dhe atë në familje.
- Bashkia Pogradec nuk ka një buxhet të dedikuar për dhunën në familje, nga buxheti i saj mbulohet vetëm paga e koordinatorit në shumën 530,880 leke të reja bruto/vit.
- Grupi Teknik Ndërdisciplinar është mbledhur 5 herë gjatë vitit 2019, ndërkohë që asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues nuk është organizuar në këtë vit.
- Bashkia e Pogradecit ka nënshkruar marrëveshje me disa organizata me qëllim dhënien e shërbimeve sociale në mënyrë më profesionale tek target grupet që kanë nevojë për mbështetje dhe dhënie shërbimi.
- Janë zhvilluar disa trajnime për rritje kapaciteti për punonjësit e Bashkisë Pogradec nga Shkolla e Administratës Publike, specifikisht për dhunën në familje.
- Sistemi REVALB është përdorur nga koordinatori i dhunës, janë hedhur të dhënat në mënyrë periodike por shpesh herë ka patur probleme me funksionimin e këtij sistemi.
- Personat e dhunuar orientohen në tregun e punës dhe regjistrohen në Zyrën e Punës, e cila informon për profesionet dhe bizneset që ofrojnë punë dhe ndiqen në tregun e punës deri sa punësohen, paralelisht viktimave u ofrohet ndihmë ekonomike kur marrin UM/UMM.
- Për vitin 2019 nuk ka asnjë trajtim të rasteve të viktimave të dhunës në familje që janë trajtuar me me bonuse sociale sa i përket qerasë së banesës .

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Pogradec

² **Neni 130/a Dhuna në familje** (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 17; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 33) – 130/a1Rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. 130/a2Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. 130/a3Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. 130/a4Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

Të dhëna statistikore nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit Pogradec

Gjatë vitit 2019 janë realizuar vetëm 5 takime të grupit teknik multidisiplinar, takimi i GTN për menaxhimin e rasteve konsiderohet si takim i mekanizmit kundër dhunës, ashtu siç vërehet edhe nga lista e pjesmarrësve, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët takimet janë konsideruar të MKR.

Në takimet e GTN-së janë diskutuar dhe trajtuar 10 raste. Për vitin 2019 nuk është referuar për trajtim asnjë rast në Strehëzën Kombëtare për viktimat e dhunës në familje referuar nga Bashkia Pogradec, pasi rastet kanë preferuar të marrin ndihmë dhe të integrohen në vendbanimet e tyre.

Koordinatori referon se rreth 15 raste të viktimave të dhunës në familje janë duke u mbështetur për ri-integrimin e tyre ku antarë të MKR kanë dhënë kontributin e tyre. Hasen shumë vështirësi dhe sfida në ri-integrimin e këtij target grupi. Zyra e punës bashkëpunon për ofrimin e punësimit por mbetet problem strehimi i viktimave me femijët e tyre në raste kur braktisin banesën.

Të dhëna statistikore nga Drejtoria e Policisë Pogradec

Përgjatë vitit 2019 pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Pogradec janë evidentuar 81 raste të dhunës në familje, ku 69 prej viktimave ishin gra dhe vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a për vitin 2019 ishte 22 dhe u arrestuan 9 autorë.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, sipas Ligjit 9669, datë 18.12.2006, janë plotësuar 54 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje. Detaje më të hollësishme të ndara sipas përshkrimeve përkatëse pasqyrohen si vijon më poshtë:

Tabela 1: Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Pogradec

Përshkrimi	Komisariati Pogradec
Evidentuar	81
Të dëmtuar gjithsej	83
Prej tyre gra/vajza	69
Kërkesë për U. Mbrojtje	54
Shkelje U.Mbrojtjes	4
V. P. Neni 130/a	22
Arrest. për 130/a	9
Ndaluar për 130/a	1
Gjendje të Lirë për 130/a	13
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Pëgjithsme e Policisë së Shtetit.

Të dhënat statistikore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec

Gjatë vitit 2019 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, janë paraqitur 58 kërkesa për Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Pas shqyrtimit të kërkesave, gjykata pranoi 54 prej tyre, duke hedhur poshtë 4 raste të paraqitura.

Në total Gjykata e Pogradecit pushoi gjykimin për 5 raste gjatë vitit 2019 dhe rrëzoi kërkesën për 10 raste të tjera. Në vijim, 9 ishin rastet kur kjo gjykatë shqyrtoi shkeljen e urdhrave të mbrojtjes.

Të dhëna statistikore nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec

Pranë Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Pogradec, gjatë vitit 2019 u paraqitën dhe 17 raste sipas nenit 130a/1,2,3,4.

U regjistruan për procedim 15 raste të ndara si vijon sipas neneve: 12 procedime 130/a1; 2 procedime 130/a3; 1 procedim 130/a4.

Ndërkohë që 9 ishin dhunuesit që u arrestuan për dhunë në familje sipas prokurorisë së bashkisë Pogradec.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objekivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Pogradec gjatë vitit 2019 ka zhvilluar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit për të mos pranuar fenomenin e dhunës në familje dhe marrëdhëniet familjare. Këto aktivitete kryesisht janë organizuar në shkollat e Pogradecit në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së fëmijës, psikologëve shkollorë dhe OJF-të që kanë aktivitet në bashkinë Pogradec. Aktivitete të tjera janë zhvilluar edhe në qytet (ambjente të hapura dhe të mbyllura) me fokus sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit që dhuna nuk tolerohet.

Në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës (25 nëntor- 10 dhjetor), periudhë e cila përkoi me situatën e vështirë në vend për shkak të tërmetit të 26 nëntorit, vëmendja e bashkisë u drejtua në zonat e prekura duke u solidarizuar me bashkitë e tjera për t'i ardhur në ndihmë popullsisë në nevojë. Peshën për organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese e mbajtën OSHC-të, veçanërisht “ Unë Gruaja”, e cila në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe me koordinatorin vendor çelën fushatën e 16 diteve të aktivizmit. Janë organizuar 13 aktivitete të koordinuara në bashkëpunim me organizatat që operojnë në territorin e bashkisë Pogradec. Këto aktivitete nuk janë realizuar me fondet e bashkisë por në bashkëpunim me institucione dhe OJF të ndryshme si pjesë e projekteve të financuara në kuadër të projekteve që janë zbatuar për vitin 2019.

Target grupi i përfshirë janë gra, fëmijë në shkolla si dhe specialistë nga institucione të ndryshme të njësive administrative dhe ato shëndetësore. Rreth 500 nxënës dhe afërsisht 200 pjesëmarrës nga komuniteti ishin përfitues të këtyre aktiviteteve gjatë vitit 2019, ku 50 % e kësaj pjesëmarrje ishin gra.

Bashkia e Pogradecit ka nënshkruar disa marrëveshje me disa organizata me qëllim dhënien e shërbimeve sociale në mënyrë më profesionale tek target grupet që kanë nevojë për mbështetje dhe dhënie shërbimi. Disa nga këto organizata janë:

- “Unë Gruaja”,
- “Shkolla Amaro – Tan (pjesë e organizatës Nehemia)”,
- “Fëmijët jetimë”.
- Shoqata “Shërbesa e Ujit te Gjallë” - e cila ofron mbështetje për fëmijët dhe familjet në nevojë. Është qendër ditore që ofron një vakt dreke dy herë në javë në fshatra. 1,200 fëmijë me një vakt dreke dhe me ushqime për familjet e tyre.
- Fondacioni “Nehemia”, - ofron mbështetje për të moshuarit, ndihma humanitare, mbështetje për restaurime shkollash, lokalesh, shërbime sociale e mjekësore, një vakt dreke për njerëz në nevojë.
- Qendra “Drita e Shpresës”, - ofron shërbime fizioterapie për personat me aftësi të kufizuar, prodhim protezash e ortezash në punishte.
- Fondacioni Diakonia Albania, është një Qendër rezidenciale jo publike - ofron shërbime për njerëzit në nevojë, kryesisht fëmijë të grupmohës 16-18 vjeç. Kapaciteti maksimal i saj është 20 persona ndërsa aktualisht ajo numëron 24 persona.
- Qendra Ditore për PAK, është një qendër publike - ofron mbështetje për personat me aftësi të kufizuar. Kapaciteti maksimal i saj është 43, ndërsa për momentin kjo qendër ka 32 persona.
- Shoqata "Foleja", funksionon si një qendër ditore jopublike - e cila ofron shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar. Kapaciteti maksimal i saj është 12 persona, ndërsa shoqata për momentin ka 9 persona që e frekuentojnë dhe marrin shërbime.

Shoqata “Unë, Gruaja” është duke zbatuar aktualisht disa projekte, dy prej të cilëve janë në lidhje të ngushtë me Bashkinë e Pogradecit dhe Drejtorinë Vendore të Policisë pasi të dy projektet synojnë ngritjen dhe forcimin e funksionimit të GTN në njësitë administrative të bashkisë Pogradec. Në kuadër të këtyre projekteve janë realizuar 14 takime me përfaqësues të institucioneve pjesë e GTN në zonat rurale. Gjithashtu në kuadër të takimeve në shkolla për ndërgjegjësim dhe informim mbi kuadrin ligjor dhe dhunën në familje janë realizuar 20 takime ku ka qënë pjesë dhe përfaqësuesi i bashkisë për dhunën në familje.

Takimet e GTN në njësitë administrative të bashkisë Pogradec kishin në qendër diskutimin e rasteve konkrete si dhe takime me komunitetin në lidhje me informacionet sa i përket dhunës, format e saj, sistemi i referimit, mjetet dhe institucionet ku duhet të drejtohen viktimat e dhunuara apo ato të riskuara.

Takimet e zhvilluara nëpër shkolla janë organizuar në grupe me nga 30 nxënës dhe janë trajtuar temat e dhunës, bullizmit, dhuna në internet dhe partneriteti me policinë për zgjidhjen e problemeve.

Organizata “Unë Gruaja” me mbështetjen e AWEN, ka ngritur një rrjet me gra në zonat rurale të quajtur “Door to Door Supporters” për të mbështetur punën. Ky rrjet bashkëvepron me GTN lokale në Njësitë Administrative, organizon takime me komunitetin dhe me gra viktime të dhunës në familje të cilat i referon për mbështetje. Rreth 80 % e pjesëmarrësve janë gra.

Janë zhvilluar disa trajnime për rritje kapaciteti për punonjësit e Bashkisë Pogradec nga Shkolla e Administratës Publike, specifiku për dhunën në familje.

17.07.2019 është organizuar nga USAID Trajnimi me temë "*Dhuna me bazë gjinore në familje dhe shoqëri me qëllim reflektim mbi ciklin e dhunës me bazë gjinore dhe pse gratë qëndrojnë në mardhënie abuzive*". Diskutim mbi iniciativa që ndërjegjësojnë dhe parandalojnë dhunën me bazë gjinore. (Pogradec)

Shtator 2019 Shoqata “Unë, Gruaja” organizoi trajnimin me temë: "*Rritja e rolit të Policisë së Shtetit në Mekanizmin e Referimit në Bashkinë e Pogradecit për parandalimin dhe reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, nëpërmjet policimit në komunitet*". (Pogradec)

Në këtë trajnim ishin pjesëmarrës Specialistët e Policimit në komunitet dhe të sektorit të edukimit pranë policisë, administratorët e njësive administrative, psikologë të shkollave, koordinatorja vendore për dhunën në familje, njësia e mbrojtjes së fëmijëve, nëpunësit e zyrës së shërbimit social pranë bashkisë Pogradec.

Trajnimi synon ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të institucioneve të Mekanizmit të Referimit të rasteve të dhunës, angazhimin për shtrirjen dhe funksionimin e punës të këtij mekanizmi edhe në njësitë administrative, veçanërisht në qartësimin e roleve të aktorëve të cilët janë personat e parë që presin dhe identifikojnë një rast dhune.

Mbështetës në zbatimin e këtij projekti ishin gjithashtu Komisariati i Policisë Pogradec, Bashkia, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor dhe Zyra Arsimore.

Bashkia Pogradec ka patur bashkëpunim të ngushtë me USAID për vitin 2019, së pari për monitorimin e performancës së bashkisë për vitin 2019 nëpërmjet Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim” në lidhje me procesin e vlerësimit të komunitetit për qeverisjen dhe ofrimin e trainimeve specifike përmendur si më sipër.

Nga informacioni referuar nga koordinatori vendor i bashkisë Pogradec për vitin 2019 nuk ka asnjë aktivitetet të organizuar nga bashkia në bashkëpunim me organizatat fetare me fokus dhunën në marrëdhëniet familjare dhe atë në familje.

Tabela 5. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
----	------	-------	------	-----------------

1	23/07/2019	Nj.A Udënisht	Advokimi dhe Policimi në komunitet	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
2	03/09/2019	Nj.A Velcan	Advokimi dhe Policimi në komunitet	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
3	12/09/2019	Bashkia Pogradec	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar Diskutimi dhe trajtimi i disa rasteve emergjente	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar Bashkia Pogradec
4	27/09/2019	Nj. Trebinjë	Ngritja e grupit ETN në njësi administrative me aktorët lokalë	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
5	30/09/2019	Nj.A Buciumas	Advokimi dhe Policimi në komunitet	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
6	30/09/2019	Nj.A Buciumas	Ngritja e grupit ETN në njësi administrative me aktorët lokalë	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
7	02/10/2019	Nj.A Cëravë	Advokimi dhe Policimi në komunitet	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
8	16/10/2019	Nj. Proptisht	Advokimi dhe Policimi në komunitet	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
9	23/10/2019	Nj.A Dardhas	Advokimi dhe Policimi në komunitet	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
10	DT 04/11/2019	NJ.A Rrëmënj	Format e dhunës dhe përdorimi i rrjeteve sociale	Shoqata "Unë, Gruaja" së bashku me përfaqësuesit e policisë së Komisarariatit Pogradec.
11	05/11/2019	Nj.A Udënisht	Ngritja e grupit ETN në njësi administrative me aktorët lokalë	Un12ë Gruaja dhe Bashk13ia Pogradec
12	DT 5/11/2019	Shkolla "Muhamer dhe Esat Minarolli"	Informimi dhe sensibilizimi i të rinjëve mbi fenomenet e dhunës	Shoqata Une Gruaja Përfaqësues nga Komisaritati i Policisë
13	DT 6/11/2019	"Nehemiah Gateëay University"	Fenomenet e dhunës, dhunës në marrëdhëniet intime midis adoleshenteve, dhunës në internet, bullizmit, ngacmimeve seksuale, konflikteve midis nxënësve, etj.	Shoqata Une Gruaja Përfaqësues nga Komisaritati i Policisë
14	08/11/2019	Nj.A Cëravë	Ngritja e grupit ETN në njësi administrative me aktorët lokalë	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
15	11/11/2019	Nj.A Çërravë	Trajtimi i rasteve konkrete dhe zgjidhja e problematikave të tyre	ETN
16	12/11/2019	Nj.A Dardhas	Ngritja e grupit GTN në njësi administrative me aktorët lokalë	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
17	13/11/2019	Nj. Proptisht	Ngritja e grupit GTN në njësi administrative me aktorët lokalë	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec

18	18/11/2019	Nj.A Proptisht.	Trajtimi i rasteve konkrete te dhunes dhe zgjidhja e problematikave te tyre	ETN
19	20/11/2019.	“Nehemiah Gateëay University” Pogradec	Fenomenet e dhunës, dhunës në marrëdhëniet intime midis adoleshenteve, dhunës në internet, bullizmit, ngacmimeve seksuale, konflikteve midis nxënësve	Unë, Gruaja, përfaqësues nga Komisariati i Policisë si dhe Bashkia Pogradec
20	25/11/2019	Bashkia Pogradec	Celja e fushatës 16 ditë aktivizim kundër dhunës në familje	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
21	31/10/2019	Nj.A Velcan	Ngritja e grupit GTN në njësi administrative me aktorët lokalë	Unë Gruaja dhe Bashkia Pogradec
22	DT 06/12/2019	Shkolla “Kozma Basho” Pogradec	Dhuna ne familje, institucionet dhe ligji që na mbron	Unë, Gruaja, përfaqësues nga Komisariati i Policisë si dhe Bashkia Pogradec
23	11/12/2019	Nj.A Dardhas	Problematikat që has komuniteti apo dhe vete institucionet për raportimin dhe mbështetjen e rasteve të dhunës	GTN
24	DT 12/12/2019	Stropckë	Dhuna në familje dhe denoncimi I saj	Unë, Gruaja, përfaqësues nga Komisariati i Policisë si dhe Bashkia Pogradec
25	DT 16/12/2019	Shkolla” Kozma Basho” Pogradec	Minimizimi I dhunes dhe denoncimi I saj	Unë, Gruaja, përfaqësus nga Komisariati i Policisë si dhe Bashkia Pogradec
26	DT 17/12/2019	Shkolla “Koli Gusho”, Pogradec	Dhunën në familje, format e saj si dhe menyrat e mbrojtjes	Unë, Gruaja, përfaqësus nga Komisariati i Policisë si dhe Bashkia Pogradec,

Burimi: Koordinator Vendor dhe shoqata Une gruaja

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në Bashkinë Pogradec që prej vitit 2008 vepron Mekanizmi i koordinuar i Referimit i cili bazohet në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në marrëdhëniet Familjare”, neni 8, pika 8 si dhe te VKM 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, hartuar në mbështetje të bazës legislative të sipërcituar.

Në kuadër të MKR një marrëveshje është firmosur midis anëtarëve të këtij mekanizmi. Qëllimi i marrëveshjes së firmosur midis antarësise së MKR është në përputhje me qëllimin e bazës ligjore mbi të cilën hartohet dhe konsiston në marrjen e masave të nevojshme përmes një koordinimi ndër-institucional për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, si edhe për ofrimin e mbrojtjes dhe shërbimeve të tjera të nevojshme pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave, fëmijëve, të moshuarve(ave) dhe personave me aftësi të kufizuara.

Koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve me synim ritjen e efektivitetit të funksionimit dhe ofrimin e shërbimeve shumë-sektoriale, qëndrojnë në themel të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.

Referuar informacionit të marrë nga koordinatori vendor, MKR Pogradec nuk është mbledhur gjatë vitit 2019 dhe nuk ka trajtuar asnjë rast kundër dhunës në familje gjatë këtij viti. Takimet që mekanizmi ka regjistruar kanë qënë të procesit teknik të tipit si nënshkrimi i marrëveshjeve dhe diskutimi për politika sociale lidhur me fenomenin e dhunë në familje.

Gjate vitit 2019 janë realizuar vetëm 5 takime të grupit teknik multidisiplinar, Takimi i GTN-ve për menaxhimin e rasteve konsiderohet si takim i mekanizmit kundër dhunës, ashtu siç vërehet edhe nga lista e pjesmarrësve, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët takimet janë konsideruar të MKR.

Tabela. 6: Raste të dhunës të trajtuara nga GTN Bashkia Pogradec

Raste te trajtuara nga GTN	Përshkrimi i rastit
Grua - NJ. A VELCAN	Rasti është mbështetur nga të gjitha institucionet e MKR. Fillimisht zonja është drejtuar tek NJMF pasi ka pasur një fëmijë të pa regjistruar të lindur në shtetin Grek. Zonja së bashku me Unë Gruaja është ndihmuar për regjistrimin e fëmijës dhe më pas zonja është ndihmuar në proceset gjyqësore si për marrjen e UM pasi kërcënohej nga bashkëshorti dhe në procedurat e zgjidhjes së martesës. Aktualisht zonja është e divorcuar. Fëmija vazhdon të vijojë frekuentimin në kopësht pasi është 3 vjeç e gjysëm dhe zonja është e punësuar në një fabrikë private konservimi në qytetin e prindërve pasi pas divorcit vendosi që të jetojë me prinderit.
Bashkia Pogradec (23/12/2019)	Trajtimi emergjent i 2 rasteve të grave të dhunuara, një nga Nj.A Velcan dhe një rast nga Nj.A Trebinjë. Në rastin e parë është bërë arrestimi i dhunuesit (kunati i viktimës) në kushte flagrante dhe rasti i dhunuesit të 2-të është me probleme të shëndetit mendor. Në të 2 rastet është bërë ndërhyrja e menjëhershme ku dhunuesit janë larguar nga banesa.
18/12/2019 NJ.A	Mbledhja e ETN e realizuar në Nj.Ad. Dardhas bëri bashkë përfaqësues nga të

Dardhas	gjitha institucionet në këtë Njësi Administrative. Të pranishmit diskutuan mbi problematikat që has komuniteti apo dhe vete institucionet për raportimin dhe mbështetjen e rasteve të dhunës, duke sjellë dhe raste konkrete për diskutim. Disa nga vështirësitë që has komuniteti në këtë zone lidhen me papunësinë, ekonominë e dobët, nivelin e ulët arsimor si dhe problemet e shëndetit mendor të cilat shpesh janë kthyer dhe në kërcënim për stafet që punojnë në këto institucione, shprehet një nga përfaësueset e sitemit shëndetësor në këtë zone.
---------	---

Burimi: Koordinator Vendor

Tabela 7. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2019 në Bashkinë Pogradec

Viti	Mbledhjet e GTN
2019	Mbledhja e parë – Datë 29/03/2019
	Mbledhja e dytë – Datë 22/05/2019
	Mbledhja e tretë – 18/10/2019
	Mbledhja e katërt - 11.09.2019
	Mbledhja e pestë- 23.12.2019

Burimi: Koordinator Vendor

Sistemi REVALB nuk është përdorur në mënyrë të rregullt nga koordinatori vendor, pasi ky sistem gjatë këtij viti ka shfaqur shumë probleme në vazhdimësi. Problematikë dhe shqetësim i ngritur jo vetëm nga koordinatori vendor pranë kësaj bashkie por edhe nga koordinatorë të tjerë vendorë në bashki të tjera nën monitorim.

Sa më sipër mosfunksionimi ka rezultuar në mos hedhje të të dhënave në kohë reale. Ngaurvejimi i sistemit dhe vetë konfirmimi i koordinatorit vendor pranë kësaj bashkie, ky sistem nuk është plotësuar me të dhëna të reja të kësaj bashkie që në muajin prill 2019, kjo si pasojë e mos lejimit nga sistemi për shtimin e rasteve të reja. Kjo problematikë është prezantuar edhe pranë instancave përgjegjëse në mënyrë zyrtare por fundi i vitit e ka gjetur përsëri sistemin problematik në funksionim.

Bashkia Pogradec bashkëpunon me Komisaratin e Policisë Pogradec në referimin e rasteve të dhunës në familje. Ky bashkëpunim provohet me numrin e rasteve të manaxhuara si dhe me rastet e evidentuara dhe kërkesë padite për urdhër mbrojtje si dhe ndalimet e arrestimet e burrave dhunues. Mbështetur në ligjin 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” policia në raste flagrante të dhunës ka nxjerrë dhunuesin nga banesa dhe ka bërë ndalimin e tyre.

Gjykata vepron menjëherë në lëshimin e UM/UMM si dhe bashkia ka ofruar mbulimin e transportit nga zona rurale tek vendi i punës për viktimat e dhunës në familje, ndërkohë që paralelisht organizatat e shoqërisë civile kanë ofruar mjete pune si makinë qepëse apo vegla pune për vetëpunësim në kushte shtëpie si dhe pako ushqimore e veshje për këtë target grup.

Për të vijuar me Drejtorinë Arsimore Rajonale, e cila ka një bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Pogradec dhe OSHC me qëllim realizmin e fushatave ndërgjegjësuese për familjen dhe fëmijët. Gjithashtu Bashkia

Pogradec është në kontakt të vazhdueshëm me psikologët e shkollave më qëllim evidentimin e rasteve të dhunës në familje. Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) është e pranishme në çdo takim të realizuar pranë Bashkisë Pogradec si pjesë e GTN-së dhe MKR.

Personat e dhunuar orientohen në tregun e punës dhe regjistrohen në Zyrën e Punës, e cila informon për profesionet dhe bizneset që ofrojnë punë dhe ndiqen në tregun e punës deri sa punësohen. Viktimave u ofrohet ndihmë ekonomike kur marrin UM/UMM. Ndihma ndërpritet në raste transferimi në një qytet tjetër ose kur përfundon afati i UM. Viktimave u propozohet ndjekja e kurseve profesionale dhe u jepet prioritet në zyrën e punës për një punësim sa më të shpejtë. Ndihma e preferuar nga personat e dhunuar është ndihma financiare dhe ajo ushqimore.

Për Bashkinë e Pogradecit ka një parashikim në rritje të buxhetit afatmesëm për sa i përket programeve buxhetore që mbulojnë funksionet 25, 26, dhe 27 të bashkisë, përkatësisht programet “Familja dhe fëmijët”, “Papunësia” dhe “Strehimi Social”.

Ndryshimet në Ligjin e Buxhetit, i kanë deleguar bashkive kompetenca të reja dhe fleksibilitet sa i përket menaxhimit të fondeve sipas nevojave, por për shkak se nuk është miratuar akoma si ligj, veprohet me ligjin e vjetër, që do të thotë se bashkia nuk mund t'i përdorë fondet për nevojat e shërbimeve që ka. Pjesa më e madhe e burimet financiare për shërbimet sociale ofrohen nga qeveria qendrore që janë buxhetet që miraton qeveria për shpërndarje në secilën bashki për plotësimin e këtyre shërbimeve. Qeveria qendrore është ofruesi më i fuqishëm i shërbimeve sociale, nëpërmjet programeve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, arsimit dhe kujdesit shëndetësor. Është përgjegjësia e saj të menaxhojë, koordinojë, financojë e mbikqyrë zbatimin e politikave sociale.

Personi që mbulonte barazinë gjinore dhe dhunën në familje deri në nëntor të 2019 ishte specialiste e barazisë gjinore, por prej nëntorit 2019 është bërë një ri-organizim dhe është emëruar koordinatori i ri vendor i barazisë gjinore, i cili është i dedikuar vetëm për rastet e trajtimit të dhunës në familje, koordinimit dhe mirëfunksionimit të MKR sipas përshkrimit të pozicionit.

Vendimi për emërimin e tij është marrë në 26 nëntor por kalimi i kompetencave është bërë me 02.12.2019. Koordinatorja e mëparshme ka kaluar në pozicionin e administratores shoqërore. Arsyeja e lëvizjes është ndryshimi i strukturës së bashkisë dhe edukimi përkatës si punonjës social aktual dhe trajnime të marra për trajtimin e burrave dhunues.

Koordinatori vendor ka statusin e nëpunësit civil dhe zbatohet legjislacioni i nënëpunësit civil. Edukimi i tij është punonjës social me Master Shkencor në “Perkatësi gjinore dhe Zhvillim”, si dhe ka kryer një specializim 2 vjeçar për të punuar me burrat dhunues.

Gjithashtu ka marrë pjesë në shumë trajnime të ndryshme që janë zhvilluar për luftën kundër dhunës në familje dhe barazisë gjinore të organizuara nga Shkolla e Administratës Publike por dhe nga organizata të njohura të ndryshme.

Bashkia Pogradec nuk ka një buxhet të dedikuar për dhunën në familje, nga buxheti i saj mbulohet vetëm paga e koordinatorit në shumën 530,880 leke të reja bruto/vit.

Bashkia e Pogradecit në buxhetin e vitit 2019 ka miratuar një fond per 3,000,000 lekë për shërbimet sociale. Këto shërbime janë në tërësi dhe jo të dedikuar për rastet e dhunës në familje por kryesisht për familjet e varfëra dhe familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore. Për vitin 2019 nuk ka asnjë trajtim të rasteve të viktimave të dhunës në familje të trajtuara me bonuse qeraje sociale .

Ndryshe nga skemat e pagesave të ndihmës ekonomike dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të përkujdesit shoqëror që mund të mbulojë nevojat e grupeve në nevojë, duke përfshirë dhe shërbimet për gratë e dhunuara dhe femijët për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase, veçanërisht në zonat rurale.

Shërbimet e kujdesit shoqëror të specializuara janë siguruar nga organizatat jo-fitimprurëse të financuara në baza vullnetare ose nga organizatat e huaja, financuar nga donatorët dhe partnerët.

Duke iu referuar informacionit të marrë nga koordinatori vendor i Bashkisë Pogradec si dhe nga monitorimi rezulton se për vitin 2019 Komiteti Drejtues i MKR Pogradec nuk është mbledhur apo të ketë organizuar ndonjë takim në funksion të çështjeve të dhunës në familje apo dhunës në marrëdhëniet familjare.

Tabela 8. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Pogradec

Viti	Mbledhjet e KD
2019	Nuk janë organizuar

Tabela 9. Përbërja e Komitetit Drejtues të bashkisë Pogradec

Institucioni	Emër mbiemëri përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Kryetar z. Ilir Xhagolli
Drejtoria e Policisë	z. Nikollaq Palla, Shef Komisariati;
Gjykata e RrethitGjyqësor	znj. Emona Muçi, Kryetare
Prokuroria e Rrethit	z. Sotir Kllapi
DrejtoriaArsimoreRajonale	z. Sotiraq Mangëri
Drejtoria e ShëndetitPublik	Zn. Elona Katiraj
Zyra e Përmbarimit	Zn. Sulela Llakmani
Prefektura	Znj. Mimoza Gusho

Tabela 10. Përbërja e GTN-së Bashkia Pogradec viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Arta Balliu dhe prej datës 02/12/2019 Arbi Basho

	(koordinatori vendor) Etleva Memia NJMF Valentina Veshollari, Mediatore komuniteti. Luljeta Mançellari, Pergjegjese Ndhimave Ekonomike
Drejtoria e Policisë	Reshit Çollaku, Kryeinspektor Leonard Dervishllari, Sektori kunder dhunës në Komisariat
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Nuk perfaqesohen pasi nuk paraqiten në takime
Prokuroria e Rrethit	Nuk perfaqesohen pasi nuk paraqiten në takime
Drejtoria Arsimore Rajonale	Mimoza Vesho
Drejtoria e Shëndetit Publik	Ermald Meko, punonjes social
Zyra e Përmbarimit	Nuk perfaqesohen pasi nuk paraqiten në takime
Prefektura	Nuk perfaqesohen pasi nuk paraqiten në takime
Kryetarët e Njësie Administrative	Nj.A Tredinjë Ermal Tola Nj.A Buçimas Alfons Olldashi Nj.A Çërravë Olger Ibi Nj.A Dardhas Erton Muçka Nj.A Udenisht Klodi Selko Nj.A Proptisht Ramiz Pura Nj.A Velçan Mentor Rapçe
Zyra e Punësimit	Liza Kreste, Specialiste
Organizata Jo qeveritare	“Une Gruaja” Eleni Jajçari, Olgerta Demmelli “Fundjava Ndryshe” Gerti Çela Shkolla Amaro Tan: Marin Piqoni
Strehëza emergjente për viktimat e dhunës	Manaxhuar nga Bashkia Pogradec
Komunitete fetare	Nuk perfaqesohen pasi nuk paraqiten në takime
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk perfaqesohen pasi nuk paraqiten në takime

Burimi: Koordinator Vendor

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Në bazë të Ligjit Nr. 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, plotësimi i Urdhërave Paraprak të Mbrojtjes, UMM dhe UM është detyrë e Drejtorisë Vendore të Policisë Qarku Korçë (Komisariati i Pogardecit), Prokurorisë Pogradec përmes padisë publike, çdo avokat si dhe OJF.

Në të gjithë rastet e evidentuara të dhunës në familje në bashkinë Pogradec të gjitha kërkesë padite për UM/UMM janë realizuar nga Policia. Kjo ndodh kryesisht për disa arsye. Së pari, me plotësimi e kërkesë padisë për UMM policia merr edhe deklaratimet e secilës palë, viktimës dhe dhunuesit, çka e bën dosjen më të plotë nga ana procedurale, e më pas e dorëzon në Gjykatë. Gjithashtu policia deklaroi se kjo kërkesë realizohet on line. Ndërkohë plotësimi i të njëjtës padi nga avokati mbrojtës i viktimës, apo nga një OJF përmban vetëm deklaratimin e fakteve nga ana e viktimës/paditëses dhe jo të paditurit/dhunues.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec i ka miratuar të gjithë kërkesë paditë për UM në masën 100% dhe të gjithë autorët e veprës penale janë trajtuar në gjëndje të lirë përveç 2 rasteve të arrestuar.

Vihet re se në asnje prej masave të dhëna nga gjykata pavarisht dispozitave që parashikon ligji i rishikuar Nr 47-2018 , dt 23.07.2018 nuk ka parashikuar programe rehabilitimi pranë subjekteve private apo publike për dhunuesit. Në qytetin e Pogradecit koordinatori aktual është trajnuar nga organizata ndërkombëtare Yamaneh në një program 2 vjecar për punonjësit social që të ofrojnë shërbim psiko-social falas për burrat dhunues. Personi i trajtuar , në këtë rast koordinatori vendor e ka marrë trajnimin për rritjen e kapaciteteve të tij profesionale, por nuk e ka ushtruar apo ofruar si shërbim përgjatë vitit 2019.

Asnjë UM apo UMM nuk shkon në zyrën e përmbarimit direkt nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ndonëse ka qënë dhe është detyrim i ligjit: Neni 19 (i ndryshuar) pika 5 *“Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.”*

Gjykata e rrethit Gjyqësor Pogradec i publikon të dhënat e saj mbi rastet e ndjekura në gjykatë në mënyrë të detajuar në faqen e saj në internet. Këto të dhëna janë të ndara sipas veprës penale apo civile, sipas kohëzgjatjes së marrjes së vendimit si edhe nëse rastet janë të paraqitura së fundmi apo të mbartura nga vitet e kaluara. Këto të dhëna nuk janë të disagreguara sipas gjinisë dhe nuk ka detaje sa i përket çështjeve të dhunës në familje, të cilat mbledhen kryesisht nga komisarati i policisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka të dhëna të sakta statistikore për UMM të pëcaktuara sipas vendbanimit; qytet, periferi apo fshat, moshës, gjinisë, statusit civil, numrit të fëmijëve, nivelit arsimor, statusit të punësimit. Gjithashtu kjo gjykatë ka të dhëna të hollësishme mbi vendimin dhe faktin nëse kërkesa për UMM është pranuar hedhur poshtë apo pushuar. Në faqen e internetit të gjykatës nuk publikohen online të dhënat e UMM/UM, ato dalin veç në shortin ditor, gjithashtu nuk publikohen online vendimet UMM.

Për vitin 2019 nuk ka të dhëna të Raporteve të përcjella nga Shërbimi i Provës në Ministrinë e Drejtësisë faqja elektronike e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Shërbimi i Provës është institucion i cili nuk përfaqësohet asnjëherë në mbledhjet e GTN-së dhe nuk e ka firmosur marrëveshjen e MKR të vitit 2016. Përveç kësaj mungon komunikimi midis koordinorit dhe kësaj strukture sepse koordinatori nuk është në dijeni të rasteve të referuara të dhunuesve për t’u trajtuar me programe të tilla. Koordinatori nuk ka informacion mbi format e aplikuar të shërbimeve apo kohëzgjatjen e shërbimit. Ofrimi i shërbimit të specializuar për burrat dhunues do të kërkojë një bashkëpunim të ngushtë midis Koordinatorit vendor dhe drejtorisë së shërbimit të provës Pogradec për referimin e rasteve dhe monitorimin e vashdueshëm të tyre.

Nga monitorimi i statistikave të referuara nga koordinatori vendor sektori i shëndetësisë nuk ka patur asnjë rast referimi të dhunës në familje dhe kërkesë për UM .

Referuar informacionit të dhënë nga koordinatori vendor rasti i një viktime dhune në familje me shenja të dukshme dhune në kontaktin që ka patur me mjekun ligjor të spitalit Pogradec nuk i është plotësuar formulari apo dhënë evidenca për dhunën e ushtruar ndaj rastit.

³Zyra e përmbartimit në Pogradec ka egzekutuar 352 raste me objekt “pension ushqimor”, 40 raste me objekt “takim fëmije” dhe 91 raste me objekt “urdhër mbrojtje”

Pranë kësaj bashkie nuk ka një program të dedikuar për rehabilitimin e dhunuesve, duke sjellë kështu mos plotësim të objektivit 3.3.

Konkluzione

- Bashkia Pogradec është një prej bashkive e cila ka mbi 11 vite që MKR funksionon (krijuar në vitin 2008) pavarësisht se treguesit për vitin 2019 tregojnë se mungon koordinimi i veprimeve të perbashkëta midis antarësisë.
- Koordinatori vendor ka qenë i dedikuar vetëm për rastet e trajtimit të dhunës në familje, koordinimit dhe mirëfunksionimit të MKR sipas përshkrimit të pozicionit.
- Pas zgjedhjeve lokale të qershorit 2019 dhe me ndryshimin e kabinetit të bashkisë ka ndodhur dhe ndryshimi në emerimin e koordinatorit vendor kundër dhunës. Vendimi për emërimin e tij është marrë në 26 nëntor por kalimi i kompetencave është bere me 02.12.2019. Koordinatorja e mëparshme është emëruar si administratore shoqërore. Arsyeja e lëvizjes është ndryshimi i struktues së bashkisë dhe edukimi përkatës si punonjës social i koordinatorit aktual si dhe ka marrë trainime përkatëse për trajtimin e burrave dhunues.
- Bashkia Pogradec ka një bashkëpunim shumë efektiv dhe reciprok me drejtorinë vendore të Policisë e cila për vitin 2019 e cila ka evidentuar 81 raste të dhunës në familje (të evidentuara nga policia) dhe ka regjistruar 54 kërkesë padi për UM drejtuar Gjykatës së rrethit gjyqsor Pogradec përgjatë vitit 2019.
- Bashkia Pogradec nuk e ka një plan veprimi të barazisë gjinore në nivel lokal, plan i cili do të ndihmonte në zbatimin e aktiviteteve dhe hapave të hartuara në mënyre të koordinuar nga të gjithë aktorët lokale dhe e udhëhequr nga bashkia.
- Bashkia Pogradec ka hartuar Planin e Kujdesit Social 2019-2023 në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, me mbështetjen teknike të Fondacionit “Ndhimë për Fëmijët” në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush Të Mos Mbetet Pas” që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP. Ky plan i kujdesit social ka përfshirë dhe target grupin e viktimave të dhunës në familje dhe rekomandimet për këtë target grup. Në këtë plan është përfshirë dhe seksioni i të drejtave dhe puna për reduktimin e dhunës në familje duke sjellë kështu një ndihmë plus në trajtimin e të gjitha rasteve të këtij target grupi.
- Duke qenë se pranë kësaj bashkie për një periudhë të mirë kohë nuk ka patur një koordinatori vendor që të koordinonte dhe të iniciohte mbledhjet, takimet e GTN-së janë organizuar nga

³ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit

anëtarë të tjerë të këtij grupi bërthamë. Edhe takimet koordinuese të MKR-së dhe Komitetit Drejtues kanë munguar.

- Mungojnë procesverbalet apo përshkrime të rasteve të trajtuara, koordinatori I kësaj bashkie ka vetëm listë prezencat e takimeve të organizuara nga GTN për vitin 2019. Kjo sjell paqartësi nëse rastet e trajtuara janë zgjidhur dhe se çfarë procedurash janë përdorur.
- Gjatë vitit 2019 në strehëzën emergjente Pogradec, e cila manaxhohet nga bashkia nuk është strehuar asnjë rast viktimë e dhunës në familje. Arsyeja kryesore është mungesa e personelit manaxhues të qëndrës, i cili duhet të bëjë manaxhimin e shërbimit 24 orë në 24. Shpesh ky rol është bërë nga Koordinatori vendor vetëm gjatë periudhës së orarit zyrtar në vetëm pesë ditë të javës.
- Bashkia Pogradec për vitin 2019 ka aprovuar një buxhet prej 3.000.000 lekësh për shërbimet sociale për kategoritë në nevojë por jo specifikisht për dhunën në familje. Buxheti i bashkisë për vitin 2019 për shërbime dedikuar dhunës në familje mbulon vetëm pagën e koordinatorit në shumën 530. 880 leke të reja, duke mos patur kështu fonde të alokuara nga buxheti I kësaj bashkie për materiale apo aktivitete ndërgjësuese për komunitetin e Pogradecit në lidhje me mospranimin dhe mos tolerimin e dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje. Në bashkinë Pogradec janë organizatat e shoqërisë civile të cilat mbulojnë shërbimet për dhunën në familje, te cilat bashkia nuk ka mundur ti ofrojë.
- Në Bashkinë e Pogradecit mjeku i familjes nuk raporton ushtrimin e dhunës. Në takime të organizuara në njësitë administrative nga koordinatori vendor dhe GTN, mjekët pranojnë se përballen me raste të dhunës në familje gjatë ushtrimit të profesionit në këto zona, por nuk i referojnë ato. Në vitin 2019 koordinatori vendor është përballur me një rast dhune në komisariatit e policisë, ku mjeku i spitalit i thirrur në komisariat nuk i lëshoi gruas raport për qëndrim në shtëpi për shkak të hematoma që ajo kishte si rezultat i dhunës fizike.
- Nisur nga vlerësimet që janë bërë për stafin e Bashkisë Pogradecit, rezulton të jetë një bashki me staf të kualifikuar dhe të dedikuar në shërbimet që ofron. Megjithatë nevoja për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e tyre mbetet e përhershme për faktin e ndryshimeve që ndodhin me kalimin e viteve dhe në kuadrin e reformës territoriale.
- Sistemi REVALB është përdorur nga koordinatori i dhunës, janë plotësuar të dhënat në mënyrë periodike por ky system gjatë këtij viti ka patur shumë problem në vazhdimësi. Problematikë dhe shqetësim I ngritur jo vetëm nga koordinatori vendor pranë kësaj bashkie por edhe nga koordinatore të tjerë vendorë në bashki të tjera nën monitorim.
- MKR në këtë bashki ka sfidë shërbimet gjithë përfshirëse rehabilituese afatgjatë rast pas rasti për shkak të mungesës së fondeve, largimit të viktimave të dhunës në një vend më të sigurtë dhe ri-integrimit të tyre në një vendbanim të ri.
- Në këtë bashki nuk ka programe të mirëfillta dhe funksionale në lidhje me rehabilitimin e dhunuesve.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Pogradecit për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të

rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Pogradec dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet organizimi i takimeve të MKR Pogradec parashikuar dhe në marrëveshjen e nënshkruar midis palëve si dhe një pjesëmarrje e plotë e të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje apo në aksione të koordinuara midis tyre. Veçanërisht është e domosdoshme prezenca dhe bashkëpunimi i institucioneve si: Zyra e Përmbarrimit Shtetëror Pogradec; Zyra e Shërbimit të provës. Këto institucione nuk marrin pjesë rregullisht në takime dhe nuk kanë koordinim me institucionet e tjera, veçanërisht me Bashkinë, sa i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.
- Përcaktimin e sanksioneve për institucionet lokale, pjesë e MKR që nuk i kryejnë detyrimet që i cakton ligji duke filluar me mos pjesëmarrjen e tyre në takime dhe bashkëpunimin për mbështetjen e viktimave.
- Koordinator i MKR-së i sapo emëruar duhet të fillojë punën për ndarjen e informacionit dhe hartimin e raporteve të takimeve të GTNse. Vetëm mbajtja e minutave të takimit apo listë prezencave nuk i shërben ofrimit të shërbimeve apo ri-integrimit të viktimës së dhunës në shoqëri.
- Bashkia duhet të hartojë një plan ndërgjegjësimit aktivitetesh gjatë gjithë vitit në bashkëpunim me aktorët e MKR dhe të buxhetuar si dhe të ofrojë shërbimin e specializuar dhe seanca të herë pas herë psiko-sociale për dhunuesit duke konsideruar stafin e saj të trajnuar në këtë fushë.
- Bashkia Pogradec duhet të dedikojë një fond të posaçëm dhe burime njerëzore për manaxhimin dhe funksionimin normal të strehëzës së emergjencës. Koordinator i dhunës dhe barazisë gjinore nuk mund të bëjë dhe rolin e manaxhuesit të qëndrës 24 orë në 24.
- Bashkia duhet të krijojë dhe administrojë Fondin Social.
- Bashkia duhet të krijojë një hartë shërbimesh sociale në territorin e saj për të ofruar një informacion të saktë viktimave për shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve.
- Rekomandohet instalimi dhe funksionimi i një linje telefonike në Bashki në përgjigje të rasteve emergjente.
- Në mënyrë që të racionalizohen burimet, është e domosdoshme që Drejtoria e Kujdesit Social, duhet të ketë një databazë me të gjithë informacionin për shërbimet e ofruara individëve, familjeve dhe grupeve vulnerabël, duke specifikuar të dhënat për dhunën në familje. Ky informacion do të ndihmojë edhe bashkëpunimin me organizata private të specializuara në fusha të ndryshme, për të plotësuar spektrin e shërbimeve.
- Të vihet në efikasitet sistemi REVALB.
- Përmirësimi i mekanizmave dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin është një mundësi e mirë për bashkinë që të ofrojë shërbime sa më koherente dhe me standarde.
- Bashkia në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare të mbështetura dhe nga donatorë të huaj të ofroj trajnime të vazhdueshme për anëtarësinë e MKR Pogradec që të ofrojë shërbime sa më koherente dhe me standarde.
- Në vazhdim të ofrimit të trajnimeve bashkia duhet të trajnojë stafin e punonjësve të shërbimit social sidomos atyre të Njësisë Administrative mbi rolin dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.121/2016 *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”* Bashkia në

bashkëpunim me Zyrën e Punës dhe bizneset lokale duhet të përfshijnë gratë kryefamiljare në programet e punësimit dhe sipërmarrjes private.

- Bashkia në bashkëpunim me OSHC duhet të punojë për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të grupeve të rrezikuara, specifikuat me programe sensibilizues të këshillimit dhe mbështetëse për çiftet e reja dhe nenat.

Për më shumë informacion në lidhje me këtë raport kontaktoni

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

E-mail: gadc@gadc.org.al

Adresa: Rr. “Abdyl Frasheri” Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë